



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 060/01-29756
Pejë, datë: 26 prill 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i –IV-të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **26 prill 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtorët e SHCK-së, znj.Hajrije Hxhijaj- zyrtare kryesore e financave, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina, përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 33 anëtarë prezent.

Me kërkesë të asambleistit z.Berat Ganiqi, kuvendi mbajti një minutë heshtje për viktimen e dhunës në familjes të ndjeren znj.Gjyljeta Ukella, dhe lus që opozitë e pozitë të luftojmë gjithë bashkë këtë dokuri.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua ky rend dite, me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 28.03.2024.
4. Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit të tejkalimit të planit të të hyrave.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes dhe rialokimit të mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 në

vitin 2024.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".
8. Shqyrtimi i informatës mbi listen e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.
9. Shqyrtimi i raportit mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.
10. Shqyrtimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2024) të Komunës së Pejës.
11. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
12. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim mungoj z.Rrustem Berisha dhe z.Granit Kelmendi.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.

Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 28.03.2024.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 32 votë pro, 1 votë kundër, u miratua procesverbali i dt.28.03.2024

4.Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ky draft plan që ka ardh nga drejtoria e zhvillimit dhe duhet të meret miratimi në kuvend për me dal në diskutim publik, pas diskutimit publik vjen verdikti final për miratim të këtij planit.

Z. Islam Husaj: një dokument i tillë për mua është mjaftë i rëndësishëm, por mendoj që pasi të miratohet në kuvend përfundimisht të implementohet ashtu siq ju e keni parapa. Ne e kemi pas edhe njëher një plan të tillë, mirëpo nuk është implementu, ka qenë në të kaluarën plani paraprak dhe kur e kemi bërë vlerësimin e implementimit të atij plani ka dal që as 20 % të tij nuk është implementu. Është pak ambicioz dhe është i rëndësishëm për mirëqenjen e qytetit tonë për shendetin, unë do të jem edhe pjesë diskutimit publik për materialin me analizu mirë, mirëpo kisha lut që të krijohen mekanizma të tilla që të implementohet qysh e keni parapa sëpaku pjesa më e madhe e tij.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent miratohet, dhënia në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit të tejkalimit të planit të të hyrave.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materiali është dërguar në mënyrë të detajuar, zyrtarja kryesore është prezent nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim e hapim diskutimin.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 votë kundër, 1 votë e përmbajtur aprovohet, miratimi i buxhetit të tejkalimit të planit të të hyrave.

6.Shqyrtimi dhe miratimi i bartjës dhe rialokimit të mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024.

Z.Drin Veselaj: vërtet është impesive me pa këtë kërkesë për rialokim, kur është votu buxheti i vitit 2024 me kujtohet shumë mirë në fjalimin tim që e kam pas, dhe jam deklaru në emër të grupit që na nuk e votojmë buxhetin. Jo, për arsye që ne nuk dojmë me votu por se ky ekzekutiv nuk është i aftë me zbatu buxhetin të cilën e bjen vet dhe e voton. E kjo më së miri e dëshmon që na kemi cdo vjet rialokim të mjeteve, ridestnim të mjeteve, sespe atë që e votojnë vet nuk janë në gjendje me zbatu deri në fund! Pra nëse e shohim kërkesen po i bie që komuna e Pejës i ka kryer të gjitha kërkesat në vitin 2023, dhe kanë tepru disa mjete dhe po kërkon me i bartë në vitin 2024. Por nëse dalim në terren i shohim rrugët, infrastukturen dhe punët të cilat kanë mbet të gjitha të paperfunduara, dhe këto mjete nuk e di prej cilave projekte kanë tepru! Më mirë kishte me qenë me shkru mjetet që nuk kemi ditë me i menaxhu në vitin 2023, dhe po kërkojmë me i vendos në vitin 2024. Por edhe e kishim votu këtë rialokim me pas shpresë që 2% kishit dit mirëpo pas 1 muaji kanë me na ardh prap rialokim i mjeteve prej ktyre kategorive me i vendos në një kategori tjetër. Ne jemi në një situatë ku çdo ditë po përballemi me këtë ridestnim, dhe ky ridestnim sipas meje dhe grupit tim është keq menaxhim ose keq planifikim dhe pastaj duhet me bo ndryshimin! Po ashtu tjetër çëshjte për blerjen e binave që në fjalimet e mija të më hershe e kam pyet drejtoreshen se për çfare bina bëhet fjalë, sepse nuk e dim a është binë sfilate apo për çfarë i duhet komunes? Sepse secili manefestim që bëhet buxhetohet, ndahen mjetet dhe me ato mjete bëhet organizimi. Prandaj dhe unë mendoj që ky rialokim nuk duhet me u votu për faktin që kish mujt së paku me vetdijesu këtë ekzekutiv, me vetdijesu kryetarin që tashme edhe këtë vit e besoj ja lëshon dikujt vendin që mundet me menxhu më mirë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: kam mendu Drin që ke msu diçka në asamble që sa je dhe mundesh me kuptu çka është rritje buxhetore, e cila ka mujt me qenë e planifikuar. Sepse buxhetin e kemi planifiku dhe tash po e bartim një rritje prej 1 milionë euro që është tejkalimi i buxheti , kjo qeveri që po thush që ska dit me planifiku, qaq i kanë besu qytetarët sa që 1 milionë euro i kanë pagu më shumë taksa dhe qato taksa na po i rishperndajmë. Është mirë që e paske vërejt që është një binë, e këto bina i mbajmë edhe i montojmë kur vjen diaspora, dhe kur vin njerzit me mbajtë shfaqje të ndryshme, sepse sa i marrim me pare diku tjetër e kemi binen tonë. Ndërsa sa i perket çështjes tjetër unë Drin deri në vitin 2054 kam me qenë kryetar llogariti ti deri athere del në pension.

Z.Drin Veselaj: kryetar, unë kam qenë në vitin 2013 asambleistë kur ti ke ardh kryetar dhe arsyeja që kam rikandidu prap është në vitin 2021 edhe kom pas qejf prap met prit si kryetar, por edhe met përcill. Ndërsa sa i perket vitin 2054 po besoj qe tu ka ngatëru me vitin 2025 që është veq i ki ndru pak datat! Po ashtu kryetar gjatë kësaj kohe mbasi po mendon që nuk pasna mësu kurgjo unë po mendoj që ish kon mirë me u koncentru për pyetjen që e bona, sespe pika e 5-të

kur folem për rritjen buxhetore kaloj, tash jemi në piken e 6-të, vetëm koncentrohu dëgjona dhe del më mirë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: janë mjetet buxhetore që na janë marr në muajin dhjetor, dhe qeto pjesë çka janë mbet pa i shpenzu po i rialokojmë, sepse duhet me i mbulu kërkesat që na kanë mbet. Veç kupto ni send që 3 milionë e 200 mijë euro janë marr, e 1 milionë e diçka i kemi bartë edhe 1 milionë i bjen 2 milionë, kurse 1 milionë e 200 mijë prap i kemi mongi qekjo është cka duhesh me kuptu dhe gjithë qytetarëve ju shpjegojmë ballëhapur, se edhe pse na kanë marr 3.2 milionë euro ne projektet po i vazhdojmë.

Znj.Hajrije Haxhijaj: fillimihstë po du me ju shpjegu që në këtë rast është bartja e të hyrave të pashpenzuara që këtë vit bartjen e ka bër ministria direkte. Ju jeni asambleist që 3 vite dhe e keni pa që bartjen e kemi sjellë në shumë totale për fondet e pa shpenzuara 592 mijë euro janë mbet si fonde të pashpenzuara. Megjithëse tash kjo pjesë është bartë dhe ne si komunë e kemi në disponim për shpenzim. Tani kanë ndrryshu procedurat për me i mbulu minusat apo mungesat edhe kryetari e shpjegoj që kemi pas mjaftë vendime gjyqësore dhe janë projektet që kontratat janë të nënshkruara dhe ne për këtë arsye e kemi bër këtë rialokim, prej një projektit të cilët ende nuk e kemi kontraktuar si projekt. Mundësi tjetër për me i mbulu mungesat nuk kemi pas dhe ligji na lejon këto rialokime, ligji i menaxhimit të financave publike dhe ligji i buxhetit neni 9 të cilin e kemi shpjegu në këtë shkresë. Vetëm e kemi bër rialokimi prej një drejtorie në një drejtori tjetër, nuk është ndryshuar as struktura ekonomike investime kapitale kanë qenë të planifikuar, investime kapitale prap po barten si investim kapital. Po rialokohet një shumë prej 102 mijë e 810 euro po meren prej projektit të instalim i ngrohjes qendrore dhe ventilimi dhe po barten në keto dy projektet të cilat janë paraqit në shkresë Rregullimi i Galerisë së Arteve në shumën prej 62 mijë e 848 euro, dhe Blerja e Arenes Profesionale në shumën prej 39 mijë e 312 euro.

Z.Berat Ganiqi: duhet me qenë shumë përgjegjës me sqaru, nuk ju kanë marr qeveria 3 milionë euro i kanë marr njerzit që ka pas obligime gjykata ndaj tyre, i kanë fitu drejtat në paga dhe në pjesët tjera që ju kanë taku sipas ligjit, pagat jubilarë. Këtu duhet me tregu dhe duhet me qenë korekt edhe me qytetarin edhe me secilin, sepse korektësia është ajo që duhet me u ballafaqu. Heren e kalume the që karamela ju kanë jep, nese për ty karamela është që fëmijës në fund të vitit me ju jep 100 euro dhe pensionistave kohë pas kohe me ju jep 100 euro, nese karamela janë që fëmijëve çdo muaj me ju jep pjesen që kemi premtu subvencion e ki gabim! Jeni mësu me këtë logjikën mos me subvencionu. Ndërsa sa i perket vitit 2054 po më vjen mirë kryetar, më në fund e ke kuptu që nuk je për kryeminister, dhe kjo tregon që i ki pranë sondagjet dhe e ke pranë realitetin.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: qeveria e cila është e përgjegjshme me ligj me i përmbush obligimet të cilin e ka miratu kuvendi i Kosovës, e jo me i shpërnda parat sipas dëshires së vet, qekjo është një qeveri e përgjegjshme. Buxhetin e Republikës së Kosovës asaj qeverie i ka tepru parat dhe ka qenë e obliguar së pari me ju dal komunave në ndihmë e mandej çka i teprojnë kërkush nuk po ju përzihet, shpërndahni sa ma shumë rëndahni sa ma shumë karamela për me rrujt pushtet.

Z.Berat Ganiqi: prap po e sqaroj qeverisë i kanë tepru dhe qato karamela që po thuh ju kanë ardh edhe qytetarëve të Pejës dhe në të gjithë Kosovën barabartë. Kemi dasht me qenë të drejt dhe të

barabartë e jo dikujt me i jep 10 hektar e dikujt kurgjo hiq, e kemi gjet këtë mundësi në mënyrë të barabartë.

Z.Drin Veselaj: zyrarja kryesore e tha një fjalë edhe shkoj, por qëllimi i krejt diskutimit tim është që na po ikim prej projekteve të cilat janë madhore, dhe po i shpërndajmë mjetet në projekte të vogla. P.sh rialokimi i mjeteve nga nxemja qendrore në palestren sportive unë mendoj që më e rëndësishme me ju bë nxemja në palester, se sa me ble binë për ambientet e hapura. Unë, kuptoj që tash që ka me qenë kohë fushate dhe ka me ju duftë për subjektin, por kryetar më mirë si subjekt me pagu një kompani që ju sjellë një binë se sa me na qu mjete dom, se veq 30 ditë zgjatë fushata!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Drin mos u nis prej asaj se çka keni vepru vet, mendoni më pozitivishtë për këtë vend, unë e ekom qit në buxhet qe me pas nxemje sportistat mirëpo nuk po bën me u realizu dhe po besojmë që e bëjm me efijenc të energjisë dhe e kryjmë këtë projekt.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 votë kundër, 1 votë e përmbajtur miratohet, bartja dhe rialokimi i mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".

Z.Drin Veselaj: ne si grup i asambleistëve të Aleances gjithmonë jemi pro të subvencionimi i fermerëve edhe kësaj radhe jem për, mirëpo me shpresen që kjo përkrahje të jet aty ku duhet, tek njerëzit të cilët punojnë dhe njerëzit të cilët kanë nevoj për këtë përkrahje.

Kryesuis Rexhep Kurtbogaj: po e përmendi që qëllimi i këtij projekti është përkrahja e fermerëve në zonat rurale freza 40 përfitues, freza 2.2m 20 përfitues, makina mbjellëse me miser 6 përfitues, shpërndarëse plehu 20 përfitues.

Z.Nezir Jahmurataj: edhe ne si grup është mirë me mbështet bujqësinë, vetëm le të përfitojnë njeërzit që puojnë shumë dhe kjo ndihëm le të shkoj aty ku shihet. E kam pa këtu tek mbjellëset ishte një çmim pak i lartë dhe kisha kërku të rregullohet.

Kryetari Gazmend Mjuhaxheri: ne po votojmë se duhet me u kriju një kodë, e pa këtë kodë nuk mundet me u bë participimi, për këtë arsye po e votojmë se krijohet kodi , përveq asaj që i ndan komuna edhe fërmeret participojnë.

Z.Berat Ganiqi: për sqarim të gjithë fermeret, e kemi pa subvencionet edhe viteve të kalume, meqenëse nuk kemi asnjë arsytim se sa kanë me kontribu 30% po thuhet po cila është shuma!Jemi dëshmitar të multikutivatorëve që kanë paftricipu fermert tanë, me shumat të cilat kur shkon ne dyqan e kanë të njejtin çmim sa kanë participu këta, jo 50 % po i njejt çmim. Pra në emer të LVV me fakte, me dokumenta, me blerje krejt i kem, po ashtu si grup i LVV meqenëse nuk jemi kundër fermerve por në këtë rrallë asbstenojmë për shkak të këtyre problemeve.

Nënkryetari Fatmir Asllani: Berat nuk është e vërtet për multikultivatorët që e the sa ka kushtu kanë participu nese nuk gaboj 250 euro, e ka kushtu 650 euro me ble 1 multikultivatorë me gjithë paisjet përcjellëse, e kemi kontraten dhe këto bëhen me prokurim publik nuk mundem me dal me çmim si në treg që kushton një, po ktu blihen 3 me paisje përcjellëse, e kemi kontraten dhe është publike dhe mundeni me pa edhe sot!

Z.Berat Ganiqi: të njejtën kohë e kundërshtoj dhe të njejtën kohë e miratoj, atë se çka tha e kemi bo me prokurim publik por nuk mundemi me dal si ne tregu qysh janë çmimet, pikërisht në treg është ai çmim duhet me hulumtu.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 26 votë pro, 5 votë të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet vendimi për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".

8.Shqyrtimi i informatës mbi listen e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.

Z.Labinot Panxha: ajo cka më ka shty me diskutu në këtë pikë të redit të dites është afati prej 5 viteve i dhënjës në shfrytëm i pronave dhe parkingjeve, krejt e dim që këto prona kanë qenë në shfrytëzim vetëm për 3 vite. Shtrohet pyetja se a është në panik të humbjen së pushtetit dhe zgjedhjeve dhe po don me ju zgjat militantëve të partisë së tij shfrytëzimin e pronave, edhe pas humbjes së pushtetit të tij me siguri që po! Sidoqoftë, meqenëse jemi ktu dhe e kemi përpara këtë listë të pronave kam një pyetje për ju kryetar dhe për drejtorin e këtij digasteri, se pse jeni kaq jo transparent me kuvendin dhe me qytetarin? Çka po fshehni duke e sjellë një informatë kaq të manget dhe kaq jo transparente në lidhje me të hyrat që Komuna e Pejës ka gjeneruara me parkingjet dhe me pronat e tjera komunale. Pse nuk e sjellni një informatë të përpiluar në mënyrë analitike ? këtu neve edhe qytetarëve na intereson me ditë për secilen pronë, se ka qenë kontarta mujore, për secilin parkingë që është dhënë në shfrytëzim për 3 vitet e kaluara. A ju kanë përmbajtur atyre kontratave ata përsona që i kanë në shfrytëzim ato prona? Për mua nuk mjafton të thuhet se nga pagesat kemi gjeneru të hyra në shumën 142 mijë euro. Ashtu siq nuk mjafton informata se nga objektet si kioskat, parkingjet, pronat tjera gjithashtu kjo drejtori ka gjeneru të hyra prej 247,982.00 euro, sipas kësaj informate që e ka sjellë kjo drejtori dmth 247 mijë euro është për gjithë vitin 2023! Neve na intereson me dit saktë shuma e kontratave të parkingjeve në rrugët "Mbreti Pirro", "Adem Jashari", "Tony Blair", "Mbretëresha Teutë", " Nëna Terez", "Madeleine Albright", dhe te seciles pronë që është dhënë në shfrytëzim nga komuna. Pra pasi që nuk po i sjellëni këto informata, neve na bën me dyshu që ato të hyra nuk janë në përputhje me kontrata të nënshkruara, dhe dikush po përfiton goxha mirë nga kjo situatë. Andaj për të na hequr dyshimet unë pres përgjigje për secilen pronë që është dhënë në shfrytëzim, duke fillu prej atyre të cilat i keni dhënë në fillim. Në tre mujorin e parë janar- mars 2024 të hyrave vetanake që e keni sjellë ktu, drejtorja e ÇPJ-së i evidenton si të hyra vetanake nga shfrytëzimi i pronave publike, vetem nga shpenzimi i pronave publike për të tjerat nuk po flasim 170 mijë euro për 3 muaj. Nese e llogarisim për 12 muaj 680 mijë euro për gjithë vitin 2024 tash drejtor kërkoj me m a shpjegu, ndërsa në informatën e pronave për vitin 2023, për të njejtat prona kjo drejtori ka

evidentuar të hyra në shumën prej 390 mijë euro për 12 muajt e vitit 2023. Këtu duhet me na tregu dikush prej juve se ku kanë shku 300 mijë euro të tjera, dhe pse nuk janë evidentu këto të hyrat në vitin 2023? Sepse për të njejtat prona po flasim si në vitin 2023, ashtu edhe për vitin 2024 të cilat kanë qenë në shfrytëzim . Pra vetem nese i keni liru biznismenat prej pagesave që dalin nga kjo kontratë, në të kundërtën këto para do të duhet të ishin të evindentume për vitin 2023! Edhe nese i keni liru ju duhet me na jem një arsye edhe duhet me na dhënë bazen ligjore se ku e keni gjet për me i liru.

Z.Arianit Krasniqi: e din edhe Drini se kemi qenë në komisionin për vlersimin e parkingjeve se u potensun pak më shpesh u ceken. Vitin e kaluar kemi thënë që janë të regjenerume 390 mijë e 109 euro, për gjithësej tona sherbimet. Parkingjet i kanë kontratat çdo 6 muaj i pagujnë, dmth i ka kap 3 mujorin e parë që me u bo pagesa për parkingje, që i bije qe kanë pagu për pjesen e parë të vitit që i bije me dal qekjo shumë afër 400 mijë euro.

Z.Labinot Panxha: sidoqoftë unë nuk e mora përgjigjen, 390 mijë euro për vitin 2023 drejtorja juaj ka gjeneru të hyra. Ndërsa në tre mujorin e parë të vitit 2024 ju i keni 351 mijë euro, tash janë edhe 9 muaj tjerë kjo shumë sa del? Po ju nuk jeni transparent, vetem na sqaroni se na këtu spo e dim, nese ju keni gjeneru të hyra 380 mijë euro për të njejtat prona në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 vetem për 3 mujorin e parë i keni 170 mijë, nese e llogarisim për 12 muaj 680 mijë euro. Ku janë mbet edhe 300 mijë euro të vitit 2023, sespe do të duhet të ishin të njejtat si në 2024, sepse janë të njejtat prona në shfrytëzim! Janë të njejtat kontrata të njejtat pagesa vetem sqaromani se çka ka ndodhë me to?

Znj.Hajrije Haxhijaj: unë vetem po du me shpjegu të hyrat vetanake në raportin e shpenzimit të buxhetit. Këtu po flasim për piken planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2024. Nuk është pjesë e realizimit, kur e cekim 351 mijë euro drejtorja për gjeodezi dhe kadaster 2024 e ka planin 351 mijë euro, ndërsa realizimi mbetet për tu parë në periudhat në vijim. Ndërsa ky 171 mijë euro është periudha e planifikimit, ndërsa realizimi mbetet me u pa në periudhat në vijim.

Z.Drin Veselaj: është mirë me tregu drejtor që dhe në qeverisje tuaj është pagu ajo shumë për ato parkingje, plus i keni jep dhe në forma të ndryshme për të cilat na kemi reagu, edhe mire që e pranove që me reagimin tonë dhe me pjesmarrjen tonë aktive në komision, kemi arit ketë shumë të mjeteve. Po ashtu unë kam qenë ai që kam insistu me vendoshmeri më të madhe, shpesh edhe duke me ofendu e injoru plot nga ju, kam insistu që këto mjete që na i inkasojmë me qenë më të mdhaja. Sepse une mendoj që shfrytëzimi i pronës komunale kur ipet në shfrytëzim interesi i komunes është që me inkasu sa ma shumë mjete. Ndërsa sa i perket planifikimit është 350 mijë euro, unë ktu po e shoh qe keni planifiku me i mar 170 mijë euro, nese nuk gaboje 263 ose 255 mijë euro nuk jam shumë i sigurt është vetem inkasimi për parkingjet të cilet na i kemi jep në shfrytëzim si komision. Kisha dasht me dit pse është ky planifikim i ultë, përderisa ju keni nënshkru kontratë për një shumë tjetër mbi 200 mijë euro ndërsa ktu është 170 mijë euro planifikimi!Me na shpjegu se çka ka ndodhë dhe mirë që keni fillu me kuptu që na si opozitë që ju kemi ndihmu në vazhdimësi që ju me përformu mirë.

Z.Arianit Krasniqi: Drin, je duke e kundërshtu veteveten të njejten kohë po thush që na kemi kontribu, mandej na keni injor, nuk e di që si komision kemi injor dikend , përndryshe ka kalu shumë mirë, vlersimet kanë qenë shumë korekte, ndërsa me injizime e media e kemi bërë hapjen e ofertave. Çështja te ajo se që e kemi parapa 170 mijë euro nuk është e vërtet, 170 mijë euro janë prej të hyrave të tjera, ndërsa këto parkingjet llogariten si kontrata të realizuara.

Z.Drin Veselaj: këtu po thotë planifikimi dhe planifikimi nuk është realizim! Tek planifikimi po thotë 170 mijë euro, nese o gabim teknik une vetem terhekna, por une kisha sugjeru ë së pari me u taku zyrtarja kryesore financiare dhe me ju sqaru se çka është planifikimi, dhe çka është realizim. Dhe unë nuk thash që jam injor dhe ofendu nga komisioni, por unë jam injor kur une i kam propozu drejtorit kam kërku me u anulë thirrjen për ankand, edhe kryetari të ka thon drejtor Drini e ka pas mirë, po mirë që e ki anulë dhe e ki qit tjetren kjo ka qenë arsyeja që thash që jam injor!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është raport informativ që mundem edhe mos me hy ne detaje kur anëtari i kuvendit e ka mundësin me ju adresu drejtorit me një email, për sqarim të atyre mos përputhjeve të shifrave dhe drejtori e ka obligim me ju kthy përgjigje!

Z.Labinot Panxha: unë po du me ju lexu çka ki cekë në raportin mbi listen e pronave cilat janë : Nga pagesët e pronave regjeneruse kemi siguru të hyra në vleri prej 142 mijë euro për gjithë vitin 2023. Ke thënë nga objektet e përkohshme kioskat dhe banesat sociale të cilat bëjnë pjesë në pagesen e qirras, shfrytëzimi i hapsirave publike, parkingjet janë 247mijë e 981 euro. Gjithësej të hyra për vitin 2023 i ke cekë janë 390 mijë e 109 euro. Tash për të njejtat qeto prona licenca, reklama publike janë 115 mijë euro, shfrytëzimi i pronave publike që nënkuptohen parkingjet janë 170 mijë euro, qirra nga objektet publike janë 51 mijë euro, takasa për parking publik 15 mijë euro, të hyra nga shitja e pasurisë e paske pas 00 euro, nese i mbledhim gjitha këto janë planifiku për afërsisht afër 1 milionë e 440 mijë euro nese nuk gaboj, ose keni gabu ju nuk është mbare me thonë që keni gabu gjatë përpilimit, vetem po kërkoj me sqaru dhe jemi në rregullë!

9.Shqyrtimi i raportit mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.

Z.Islam Husaj: nga raporti që unë e pash, asnjëri nga këshillat lokal nuk e ka plotësuar kriterin që është i përcaktuar, që duhet me i mbajt 6 takime brenda vitit, ka me 5,4 3 takime! Kshtuqë duhet në të ardhmen me kërku nga këshillat lokal, më shumë takime me qytetar dhe me bo procesverbale.

Z.Nezir Jahmurataj: pajtohem me drejtorin, dhe është mirë që këto këshilla që i kemi zgjedh dhe kemi hek keq me qenë më pak të shpërndam, dhe në takime m e thirr edhe asambleistave që i takojnë atij komiteti.

Z.Naim Bytyqi: një pyetje për Nezir pasi foli i fundit, a i keni mbajt 6 takime ju në fshatin Lybeniq? Dhe për Jonuzin mbasi po e përfaqëson drejtoreshen amundsh me na prezentu,

procesverbalet besoj që i ki por listen e nënshkrimve se kush ka marr pjesë në takime? Dhe a ki ndonjë fakt të takimeve të Këshillave me OSBE-në, KFORIN dhe me OJQ-të të ndryshme duke përfshir edhe ndonjë prezentim të fotografive. Po ashtu i hulumtova në rrjete sociale të këtyre këshillave lokal pash që ka dëshmi të disa aktiviteteve, por jo aktivitet për kto takime. Unë, kisha dasht me pa sot prej teje listen e nënshkrimeve të pjesëmarrësve të këtyre takimeve.

Z.Jonuz Hajzeraj: deshta me u ndërlihdh me pyetjen e z.Islam, raporti është për 6 mujorin e dytë të vitit të kaluar dhe normal që nuk janë 6 takime. Ndërsa te pyetja tjetër për me i thirrë përfaqësues të saj zone, tash nuk e di a lejohet a jjo q ë kryetari i asaj zone ta thirrë në takim një përfaqësues politik mrenda mbledhjes, këtë nuk e di sespe nuk e kam lexu ligjin saktë. Tek pyetja e z. Naim, po thush që ke qenë preznet në lokalitetin tënd atje. Në procesverbale që i kanë dërgu kryesues të këshillave lokal në shumicen e rasteve i kanë të dokumentuara edhe ne facebook të tyre privat. P.sh kryesus i këshillit lokal nga andej nga vi une z.Kadri Mavraj jo që i ka mbajt takimet por i ka tejkalu takimet me organizatat ndërkombëtra, me këshillin lokal, me kërkesa dhe me të gjitha. Ndërsa për procesverbale i kam të gjitha në zyrë, dhe mundem përmers email-it tëju përgjigjem të gjithëve.

Z.Berat Ganiqi: janë dy që po du me i permend dhe nuk i përkasin subjektit tim por duhet të permendim edhe të keqen edhe të miren. Janë dy kryetar këshillave lokal z.Kadri Mavraj dhe znj.Valbona Avdijaj, nese punohet mbas këtyre të dyse se punojnë në terren kryetarët e kshillave lokal të tjerë, kisha me qenë edhe vet i kënaqur sespe janë dy puntor më të mëdhaj që i shoh. Andaj duhe me i marr si model këta dy kryetar me angazhimet i tyre dhe me punen e tyre ndaj atij komiteti e kalon cdo pritshmëri.

10.Shqyrtimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2024) të Komunës së Pejës.

Z.Berat Ganiqi: edhe për këtë pikë kam me ju drejtu 33 asableistëve që janë prezent, që janë pjesëmarrës në mbledhje me kuptu në atë se çka po du me thonë, nuk janë akuza por me ju tregu se ku po shpenzohet buxheti i qytetarit dhe ku po shkon! Për secilen pikë e pikë kemi me sqaru se çka po ndodhë. Në tre muajt e parë të vitit 2023 e kam bë një krahasim tek mirëmbajtja e veturave, kemi pas për mirëmbajtje për vetura 3.305 euro. Ndërsa për vitin 2024 këto shpenzime të mirëmbajtjen e veturave arrin shifren 15.530 euro, gati 100% më shumë se në vitin 2023. Avokatura përfaqësim 3 muajt e parë të vitit 2023 i kishte shpenzim 4,431 euro, ndërsa në vitin 2024 i ka 18.843 euro. Lind pyetja se çka ka bo avokatura dhe se sa lënd i fitoj dhe çka fitoj? Pothuasje të gjithë lëndet i humbi dhe po shihet sot buxheti i komunës për shkak të humbjeve. Karborant për vetura këtu duhet të sqarohemi më së shumti, se kjo akuzë te dikush duhet me shku dhe duhet me jep përgjigje për këtë sepse nuk po them që kryetari e ka mar këtë naftën, se ma shumë e shoh në këmb se sa me veturë të komunës, mirëpo dikush po e shpenzon! Për tre mujt e parë të vitit 2023 shuma për karborant të shpenzuar ka qenë 56 mijë e 53 euro, ndërsa në vitin 2024 kemi 65,980.65 cent të shpenzuara, nese këtë shumë e pjestojmë me 1.40 që me këtë çmim se mer komuna naften, i bije që janë hargju 47.128.00L naftë. Për 90 ditë pa i nda ditet e vikendit me i pjestu i bije që komuna e Pejës i ka shpenzuar 523 e gjysë litra naftë në ditë. Nese

një veturë mesatare i hargjon 12L naftë për një relacion Pejë-Prishtinë-Pejë, i bije që komuna e Pejës në këtë relacion për çdo ditë pa ndal, shtunde, dille i ka nis kah 43 vetura. Unë, jam i vetdijshëm që asnjëri nga asambleistët naftë nuk ka marr as të opozites dhe as të pozites nuk kanë marr, po ashtu as kryetari i komunes se e kam pa në këmb nuk muj me thonë o duke shetit me veturë, ama dikush që po vjedh këtu është duke vjedhë! Kryetar, pom vjen keq nuk është akuzë për ty, po dikush o duke e pi duhanin me këtë naftë, se 523L naftë në ditë i bije që 43 zyrtar po shkojnë cdo ditë për Prishtinë dhe kthehen!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: pagesat e e këtij 3 mujori janë edhe obligimet e vitit të kaluar. Kur i kanë marr përmbaruesit për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale, na nuk kemi pas qysh me i pagu shpenzimet e karburanteve, shpenzimet e mirëmbajtjes së veturave janë pagesat shtator- dhjetor janë shpenzimet e vitit 2023, të cilët bartë në këtë vit janë pagu në tre mujorin e vitit 2024.

Z.Berat Ganiqi: kryetar, në vitin 2023 tre mujori i parë kemi për naftë të shpenzuara 56 mijë e 53 euro, ndërsa për vitin 2024 tre mujori i parë është 65,980.65 cent

Kryetari Gazmend Muhaxheri: janë të bartura shpenzimet shtator-dhjetor të 2023 sespe nuk kemi mujt mee i pagu se na ka marr përmbarusi dhe i kemi pagu në tre mujorin e parë të këtij viti 2024.

Z.Berat Ganiqi: në rregullë tejkalimi është për 9 mijë 927 euro, çka ka ndodhë me 56 mijë e 53 euro naftë? Te nafta po du mu ndal se tek nafta ka shpenzime shumë, për djegje nafta është e veqant e ka një kodë tjetër, për vetura këtu po thotë po flas çka ka të shkrume, tejkalimi edhe nese ka ndodhë është vetem për 9 mijë e 927 euro.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: paguhet transporti i nxënsave, përsoneve që janë me dializë edhe e kemi transportin e shkolles Vitomerices. Janë tri shpenzime ekstra që nuk janë në vetura dhe duhet me i raportu.

Z.Labinot Panxha: nese në vitin 2023 janë gjeneru të hyra prej 390 mijë e 109 euro, në planifikimin e vitit 2024 në tre mujorin e parë janë planifiku të hyra prej 351 mijë euro, sipas kësaj likste nese e keni shkru ju duheni me dit, e nese jo mereni materialin dhe lexojeni. Që i bjen për 12 muaj të vitit kjo drejtori ka me i gjeneru të hyra sispas këtij planifikimit 1 milionë e 440 mijë euro. Pyetja ime është pse në vitin 2023 nuk i keni gjeneru të hyra 1 milionë e 440 mijë por i keni gjeneru të hyra vetem 390 mijë e 109 euro? Sepse të njejtat prona janë në shfrytëzim dhe për të njejtat prona keni planifiku edhe 2023 edhe në vitin 2024!

Znj.Hajrije Haxhijaj: na ktu e kemi paraqit raportin për shpenzim të buxhetit për tre muaj, realizimi i vitit 2023 në tabel është tre mujor Janar-Mars, te planifikimi i buxhetit është kompelt për vitin 2024 janar-dhjetor. Nuk është plani që po thush 1 milionë por është palni 351 mijë për krejt vitin 2024.

Znj.Mubera Belegu:lidhur me të dhënat e punësimit në janar e kam bo një pyetje kam bë pyetje kush jonë 70 veta në asamble komunale, pom vjen mirë qe e keni mar parasysh vërttjen time tani numri aktual figuron 35, në sqarim me keni thënë që përveq asambles janë stafi i kuvendit dhe komisonet, e analizova mirë nuk po e shoh tash stafi ku figuron? Po ashtu te numri aktual i çështjeve gjinore ktu po e shohim 1 person, ne e dim që na që 3 vite nuk kemi zyrtar për çështje gjinore!

Z.Hajrje Haxhijaj: te plani i punësimit me aprovimin e ligjit të ri të pagave ka ndryshu edhe politika e planifikimit të stafit. Në vitin 2023 plani i asambles komunale numri t stafit të asambles nuk është llogarit si pagë, me aprovimin e ligjit të ri plani i asambles komunale llogaritet si pagë. Ndërsa në lidhje me zyrtar për çështje gjinore, vetem është hap konkursi dhe së shpejti do të plotësohet zyrtari për çështje gjinore.

Znj.Hidajete Nikçi: sa e perket raporti tre mujor unë kisha mu ndal tek punësimi, po shohim që të punësuar për këtë tre mujor janë gjithësej 61 persona. Kam një pyetje a është punsuar ndonjë person me afëtesë të kufizuar, përderisa kuorta thotë që çdo i 50-ti person duhet të jetë me aftësi të kufizuar sipas ligjit? Po ashtu një pyetje tjetër po e shoh që në krahasim me planifikim te arsimit fillor kanë qenë të planifikuar 175, ndërsa tash janë të punësuar rreth 1000, po ashtu edhe te planifikimi i mesem shoh që kanë qenë të planifikuar 377 e tash janë 380 shoh një shtim të numrit të punëtorve, e di mirë dhe të gjithë mësimdhënësit që janë punësu nëpër shkolla nuk janë në listë të pagave. Athere dua të di një arsye se pse është bër shtimi i tyre dhe pse këta të tjerët nuk janë në listen e pagave, sepse janë që tre muaj që punojnë në shkolla!

Znj.Hajrije Haxhijaj: sa i perket numrit të punësimit nese e krahasojmë me plan me aktal del numri 76, te sherbyesit civil janë punësu rreth 36 punëtor. Ndërsa sa i perket nr të arsimit fillor dhe i mesem, ne e dim që të mësimdhënësi llogaritet gjysemnorme edhe ata dy zyrtar vetem si staf po ajo është një normë. Na lejohet këto planifikime te arsimit fillor dhe i mesem vetem mos me u tejkalu stafi aktual dmth nr i planifikum 2211, edhe nuk tejkalohe numri ktu i ki 1157 a të punëuar i ki 1463 te programi i arsimit dhe i shkencës.

Z.Islam Husaj: një pyetje për zyrtaren çka po bëhet me pagesen e komisionet të komiteteve të kuvendit? Janë disa komitete që janë obligative e thotë Ligji për Vetqeverisje Lokale, kuvendi i ka themelu dhe egzistojnë edhe udhëzimet administrative në funksionimin e atyre komiteteve dhe ende kurgjo nuk ka për këto komitete, çka po ndodhë?

Znj.Hajrije Haxhijaj: ne jemi duke e diskutu mundësinë ekzekutimin e ketyre pagesave, ju e dini që problemi ka qenë pagesa se sa duhet të bëhet sepse asnjë udhëzim administrativ nuk tregon se sa duhet me u bo meditja dhe jemi afër të marrjes së një përgjigje finale që do të ju njoftojmë.

Z.Islam Husaj: në udhëzim administrativ për komitete konsultative, shkruan se paguhen ekuivalent me komitetet obligative të kuvendit.

Znj.Hajrije Haxhijaj: shkrun për dy komisonet që janë obligatime.

Z.Islam Husaj: në udhëzimin administrativë për komitetet konsultative shkruan, anëtarët e komitetit paguhen ekuivalent me pagesën që bohet me komitetet obligative për jo më shumë se 6 seanca në vitë. Kështu shkruan dhe kështu është në udhëzim administrativ.

Znj.Hajrije Haxhijaj: asnjë komunë deri me sot nuk e ka krye asnjë pagesë për komitete, është problem i përgjithshëm sepse ligji i pagave nuk i ka parapa dhe ne jemi në konsulltim se qysh me gjet mundësi me u pagu këto komisione.

Z.Labinot Panxha: asambleist që janë të punësuar në institucione publike e të cilët nuk janë në komitete, këta asambleist nuk paguhen prej kuvendit komunal Pejë, paguhen vetëm ata asambleist që janë të punësuar por që janë në komitet por njëkohësisht paguhen edhe ata asambleist të punësuar por nuk janë në komitete paguhen vetëm 30% të pages bazë të asambleistit. Me cilin standard jeni duke i pagu nëq një asambleist është i punësuar në institucione publike dhe nuk është anëtar i ndonjë komiteti, ku e keni marrë bazën ligjore me pagu qat shtesë prej 30%? Dhe nëq një asambleist është i punësuar në stektorin publik e është anëtar i komiteti pse paguhet vetëm 30 %?

Znj.Hajrije Haxhijaj: jeni në dijeni që kategoria e pagave dhe meditjeve më shumë menaxhohet nga MAPL-ja apo departamenti që është në kuader të thesarit. Si staf jeni emru gjithë 35 deputet, por si staf i rregulltë aktiv janë këshilltarët që nuk punojnë në asnjë staf publik.

Z.Naim Bytyqi: një pyetje për të hyrat kodi ekonomik 50212 Licensat, reklamat publikimi pronave publike, pse nuk kanë të hyra nuk ka fare, e di që është 3 muhori i parë i vitit por duke marrë parasysh 3 muhorin e vitit të kaluar kanë qënë 22 mijë e 454 euro, por pse janë 0 të hyrat?

Znj.Hajrije Haxhijaj: është gabim teknik, parat janë po janë të destinuar në kategori të tjera varesishtë ku kanë qënë të planifikuara.

Z.Naim Bytyqi: shqetësimi është se ata që i kanë shfrytëzuar ato hapsira, a kanë bo pagesa? Se nese nuk është evidentu nuk është problem.

Znj.Hajrije Haxhijaj: po janë bërë pagesat dhe janë bartur në kode të tjera.

Z.Drin Veselaj: është e 10-ta here që po thuni na ka ik ky gabim, është gabim teknik, kemi të bëjmë me një raport që na duhet me pas jo me gabime teknike sepse na i shqyrtojmë dhe e trajtojmë . Ather mundem me ju hy edhe ne hak ,kjo është sa për me mbrojtë veten por keni pas kohë me bo raportin, sepse nuk është për 300 vjet ky raport por vetëm për 3 muaj , kjo nuk është formë të cilën ish dashtë me u raportu ktu! Sa i perket raportit në brendësinë unë desha të ndalem tek të hyrat në drejtorinë për ÇPJ, për shfrytëzim e pronave. Është bërë planifiku 170 mijë euro për krejt vitin, nese nuk është edhe ky ndonjë gabim teknik. Vetëm prej parkingjeve që i kemi jep si komision është 263 mijë euro, qysh mundeni me planifiku më pak mjete se ato që i keni me kontratë 10 vjeqare, nese o gabim teknik vetëm me pranë që është gabim. Një çështje tjetër tek

shpenzimet, është interesant se çdo vjet po shkon duke u rrit shpenzimet për akomodim dhe udhëtim jashtë vendit për zyrtar. Në tre mujorin e parë të vitit të kaluar ka qenë 385 euro, për akomodim gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit. Shpenzimet e tjera që na nuk dim as qfarë shpenzime janë vitin e kaluar kanë qenë 564 ndërsa këtë vit janë 1360 euro. Te akomodimi zyrtar është 2162 euro. A ka ndiku liberalizimi i vizave që janë rit çmimet, sespe një pjesë e zyrtarve nuk kanë pas mundësi me i pas bvizat përveq një grupi të caktum, apo çka është kjo rritje kaq e madhe? Ndërsa sa i perket derivateve të automjeteve, kto vetura zyrtare njihen që hargjojnë minemalishtë, ndërsa kto po del që po hargjohen jashtëzakonishtë shumë!

Znj. Hajrije Haxhijaj: sa i perket të hyrave vetanike dua me ta shpjegu se unë nuk kam qenë pjesë e planifikimit të hyrave vetanake. Ky planifikim është bo në vitin 2023, e ki pas këtë plan në KAB dhe nuk jam në dijeni a ke jep vërejtje për këtë plan, dhe sa i perket gabimeve teknike muj me të thonë që ka ndru pak mënyra e inkasimit të hyrave, janë degjitalizu shenimet thesari i ka bo këto gabime munden me ndodh nuk është që nuk mundem me u përmissu, por ne jemi mundu që gjithçka me shku në bazë të hyrave. Aty ku ka plan, aty duhet me pas edhe realizim.

11.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur.

12.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Feriz Gashi: po e filloj një pyetje për kryetarin, a keni fillu shpërndarjen e bursave dhe nëse po në bazë të cilës rregullore?

Kryetari Gazmemd Muhaxheri: bursat i kemi shpërnda në bazë të thirrjes që e kemi bo për studentat e matematikes, fizikes, dhe teknologjisë informative, ata qe kanë apliku të gjithëve ju kem i nda bursa dhe pagesa është kry.

Z.Naim Bytyqi: fillimishtë kërkoj falje që në këtë pikë më duhet me sqaru pë një problem i cili ka ndodhë këto ditë, mirëpo do të jem shumë i shkurt nuk do e zgjasë. Ditet e fundit ashtu siq e dini ndodhen disa ngjarje të cilat nuk ishte dasht të ndodhëshin, shqetësimi im ishte kur kryetari i komunës u mor me ofendime ndaj një asambleisti(ndaj meje) dhe aq më keq ku unë nuk kam qenë prezent ndaj atyre ofendimeve. Ofendimi ndodhi në prezencen tjetër të asambleisteve dhe ekzekutivit, dhe sot këtu po dua me ju shpjegu artë dhe thjeshtë dhe sa më e kuptushme. Problemin të cilen e kam pas këto ditë me kryetarin, unë mendoj që ky konflikt i ka dy anë, njëren anë është buxheti të cilen unë e kam konsideru që është i demtura dhe vazhdoj prap të konsideroj që buxheti është i dëmtuar. Në anen tjetër është Naimi që e proreklamon dhe po e sqaron dhe po mundohet me i vetdijesu gjithë qytetarët dhe ekzekutivin që buxheti po vazhdon me u dëmtu. Gjatë fjalimit tim në seancën e jashtëzakonshme filluan përshpëritjet mbas shpine nga ana e kryetarit ku gjatë 8 min e gjysë, përshpëritjet nuk kanë ndaluar për asnjë qast. Ndërsa unë sot po ju them para juve se ngatresa ime me kryetarin është vetem me vërjetjet e mija në

lidhje me buxhetin, nuk kemi asgjë personale dhe unë personalisht nuk kam asgjë personale. Unë, nga këtu po ju lajmroj se buxhetit të komunes sonë do t'i vin ditë të vështira, se dikush e ka keqmenaxhu dhe pasojat po vin sot. Pas këtij fjalimi kryetari le të më ofendojë, kërcënojë, unë e duroj! Pa dasht me u viktimizu vajza ime ka hezitu kto ditë me shku në shkollë u frigojke që shokët dhe shoqet do ta tallshin në lidhje me ofendimet që kryetari i komunës tonë i ka bo! Mirëpo pak rëndësi ka sepse buxheti prap se prap po vazhdon me qenë i dëmtuar. Edhe nese vajza ime është shqetësu pak rëndësi ka sepse buxheti po vazhdon me qenë i demtuar edhe prindi im 77 vjeçarë nëse është shqetësu pak rëndësi ka, buxheti prap se prap po vazhdon me qenë i demtuar, edhe ne LDK me qenë prap duhet me ju tregu që buxheti është i dëmtuar. Pra edhe sulmet edhe ofendimet që i kam mar në telefon këto ditë nuk ka qenë e lehtë, por unë do të vazhdojë të kontribojë për mirëqenjen e qytetarve, duke e nxjerr ata se unë çka mendoj që është e vërtet. Andaj në fund po ju them ndoshta ju mund të bëni përpjekje dhe mendoni që Naimit mund të j'a ulni koken, por unë nuk i kam frikë askujt e në këtë rast as kryetarit të komunës sepse unë jam kundër atyre që po e shkelin ligjin.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: realitete objektiv është ajo se çka mundohem me prezentu dhe dikush mundohet që fiksinin e tij me qit si realitet. Unë, nuk i kam faj atyre që fiksinet e tyre mundohet mi paraqit si të vërteta. Unë, kam shpjegu që buxheti është i dëmtuar për shkak të përmbauesve të kontrates kolektive që komunës tonë ja kanë mar 6 milionë euro, dhe ky është problemi personale me Naimin nuk kam kurgjo, po duhet me qenë burrë e me ndegju kur ja kthej përgjigjen. Dhe është shumë e keqe që ky thotë kam sende të gjykates që i shkon këtij përsoneit e nuk i vjen komunes, është diçka teper e rrond që një vendim i gjykates me i shku një njeriut dhe komuna mos me pas! Patem një theksim të ma hershem që po pagujmë shumë avokat, komuna i ka tre avokat dhe asnjë lëndë nuk e ka humb me palë të treta përveq kësaj lënde të kontrates kolektive. Dhe unë atyre avokatëve nuk kam pas çka me bo, se është një kontratë që e ka nënshkru ministri me autorizim të kryeministrit. Nuk ka lidhje në kohen e ciles qeveri ka ndodhë por është dëmi i komunave. Se kur po o puna Berat me i mar meritat po i merni, është ardh kryeministri ja ka pre shiritin impiantit 23 milionë euro, për cilen se ka pas asnjë meritë por është ardh e ka pre shiritn dhe ka mbajt fjalim.

Z.Islam Husaj: të nderuar koleg unë dola këtu e ndoqa shembullin e Naimit, por ska telashe! Unë, për veten tim kam respekt për të gjithë ju dhe për qytetarët që ju kanë jep voten, dhe për obligimet që i keni si anëtar me i rregullu çështjet që kanë të bëjnë me qytetarin. Dola këtu sepse disa here në seancë edhe në seancen e kaluar edhe në këtë seancë pata ngacmime, nga koleget e mi duke e përmend emrin tim, duke me thirrë se duhet me vepru kështu apo ashtu! Kur kemi të bëjmë me ofendimet duhet me pas parasysh si dhe çka po ofendoni ju. Në seancen e kaluar na keni quajt budallë, të paditur, deshtak, na keni quajt rrenca që kemi rrejt, na keni thënë qe na keni thirrë me ju mbulu budallaqet e juaja kështu na u tha!. Janë thënë dhe shpik fjalët që nuk kanë egzistu në kuvend dhe nuk i ka thënë askush. Është thënë që ka thënë kryetari ju paloj, dhe unë kam qenë prezent këtu dhe e kam shiku edhe 3 here inqizimin e seances dhe kerkund nuk gjindet fjala paloj, u tha sa pë reklam. Na u tha qe ne anëtarët e LDK-së nuk mendojmë me koken tonë,

por vetem atë që na thotë kryetari, që për mua është një ofendim shumë i rënd. Jam që 24 vite anëtar i kuvendit, kurrë asnjëherë asnjë kryetar as Ali Lajçi, Ali Berisha e as Gazmend Muhaxheri nuk më kanë thirr me më thonë votoje këtë pikë kshtu ose ashtu, asnjëherë ju betohem ktu para jush, gjithmonë kam votu me logjiken time, dhe me mendjen time. Edhe pse ne na keni quajt edhe hajna, u tha në këtë senacë se dikush ka vjedhë ktu dmth jemi hajna, dhe nga diskutimet që unë i ndegjova dhe po i dëgjoj në çdo senacë po e shoh që ju nuk po dini as materialet me i kuptu. Kërkoj falje që po ju them po këtë e vërtetut ju që sa e sa here. Nuk po e dalloni se çka është planifikim, dhe çka është realizim, nuk po e dalloni se cili është vitin 2023 dhe cili është 2024, dallojnë. Po ashtu edhe matematiken duhet me dit pak më mire sepse 170 mijë here 3 mujorsha janë 510 mijë e jo 680 mijë euro. Të gjitha dikustimet e juaja kanë qenë të pa argumentume, është thënë e keni shkel ligjin mirëpo në asnjë rast nuk thuhet cili ligjë, cili nen dhe me çka është shkel. Kur i themi dikujt e ke shkel ligjin për këtë duhet me pas fakte dhe argumente, dhe jo pa asnjë bazë e asnjë faktë. Duke i mar parasysh të gjitha këto po shihet që ende nuk e keni kuptu rolin e opozites. Opozita duhet me qenë opozitë konstruktive dhe me i permend të gjitha gjërat e mira që bëhen në këtë komunë, dhe me i përkrah ato të mira që po bëhen dhe pastaj me i permend ato lëshime që behen me argumente. Por duhet me qenë edhe konkurse sepse duhet me propozu edhe opsionin e juajapër zgjedhjen e një problemi, që unë ende nuk e kam pa një propozim të tillë që ju keni propozu! Po ashtu është thën që planifikimi i buxhetit është bë keq, por a keni mar pjesë në degjime buxhetore, nese jo pse? Dhe nese keni mar pjesë a keni bë ndonjë propozim? Dhe a keni ndonjë propozim që e keni bë në kuvend qoftë në degjime buxhetore, komitet për ndonjë projekt të caktuar e nuk është fut në buxhet? Andaj mendoj që ende nuk jeni të përgatitur për me mar pushtetin, dhe kur e kaloni klasen e opozites athere flasim për pushtet.

Z.Bujar Agusholli: një pyetje për kryetarin, çështja është te dy rrugë që fillojnë te varrezat dhe përfundojnë në trazit, nuk figorn as që është pronë e komunes dhe nuk figuron as që është pronë e ministrisë së qeverisë! E pata një pyetje për kryetarin , nese kryetari dëshuron që atë rrugë me ja bartë komunes kishte me qenë e udhes, por nese jo athere ne si pushtet në nivel të lartë është mundësia që ajo rrugë gjithësesi të rregullohet në të gjitha format juridike. Edhe një propozim pasi paskemi njerzë që duhet me na msu trajnimet opozitare, dr.Islami le ta fillon me siguri do të marim pjesë dhe do të përfitojmë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: traziti në pjesen ku shkon kah Rozhaja dhe Vitomericë në planet e rruges dhe marveshjen që është punu edhe ktu prej qeverisë së përparshme ka qenë rregullimi i rruges prej shkolles “Smajl Hajdari” me lidh me rrugen që po dojnë me bo me tunell kah Rozhaja . Nuk e di tash ku ka shku marveshja që e ka bo ministri Aliu me qeverinë e Malit të Zi! Ndërsa kjo pjesa tjetër që i thojnë prej ures Kforit në Deçan tash me planin e përparshem që ka qenë është projekt i devijimit që del te Raushiqi poshtë . Janë dy projekte te ministria dhe nuk janë punë të nivelit lokal, janë ttë emrume rrugë të nivelit racional.

Z.Labinot Panxha: kryetar, kohëve të fundit je bë viral me këtë muhabetin që unë jam katundar dhe i punoj 5h tokë. Të kanë pa bashkëvendasit e mi atje në Lugun e Baranit, Kosuriq e në

Glllogjan tha a po i thush Gazit na i kemi 100h tokë që spo mundem me i punu, sepse ju nuk po ju rregulloni rrugen që është në gjendje katastrofale dhe nuk je shku ndoshta as me pa! Më heret folem për zhvillim e bujqësisë por edhe kjo bën pjesë aty, dhe ish kon mirë me ardh me shtru me zhavor janë fiks 100h tokë që nuk punohen për shkak të rruges së keqe që nuk mundet me kalu me asnjë mjet! Ndërsa te dr.islami me shumë vemendje e ndegjova edhe me erdh mirë që e pash përpara duke ja respektu moshen kur filloj u ndiva mirë, deri në momentin kur krejt foli se kush po ofendon dhe në fund filloj me na ofendu ky vet, por ska dert unë prap ja respektoj moshen!

Kryetar Gazmend Muhaxheri: sa i perket atyre rrugve Glllogjan e Kosuriq unë jam kampion për realizmin e projekteve në të gjitha fshatrat, kerkesë për atë rrugë nuk ka pas por janë degjimet buxhetore Korrik-Gusht dhe i diskutojmë kërkesat.

Z.Islam Husaj: të dytë me permend dhe ju kisha lut mos të më permendin kur nuk ka nevoj. Po ashtu e falenderoj kolegun për respektin ndaj moshes sime, por dua një pyetje a është në rregullë me ngrit një qështje që për mua është e rrendë kur thotë që vajza ime është frigu me shku në shkollë ngase frigohet mos po i ndodhë diçka, dhe e lshon senancen e del pa tregu se nga kush po frigohet dhe kush po e kërcenon kjo nuk tejkaloheht ashtu thjeshtë!

Z.Berat Ganiqi: çështja që deshta me ngrit është se një prind është anku e ka djalin me autizem në moshen 10 vjeqare, meqenëse një qender është mbyllur ka kërkuar që me ngrit si çeshtje. Jam dakord që duhet me ngrit si qeshtje edhe në nivele me të larta të qeverisë por edhe komuna duhet me pa një projekt, që duhet me ngrit një qender në Pejë që kanë orrë shtesë keta fëmijë dhe munden me shku me u aftësu, sespe shumë të kushtushme ishin seancat siq më tha dhe ato shuma janë të papërballushme për familjet që kanë nevoj. Te çështja e debatit në asamble jam mundu që çdo here me qenë korekt në debat pa ofendu, e permenda që dikush ka vjedh ktu unë krejt asambleistat i përjashtova po ashtu edhe kryetarin, kush don me dëgju degjon . Sa i perket te shprehja e kryetarit ai vet e ka pohu në emision, ju e keni mire që ajo nuk është dëgju sepse kryetari e ka thënë jashta mikrofonit nuk kemi ndonjë problem, por nuk është në rregullë si shprehje. Si çështje tjetër sa i perket ofendimeve nese pe marrim kështu në çdo senacë këtu më tregojnë çështjen të patriotizmit. Unë jam djali i Agim Ganiqit dhe jam krenar që jam djali i tij e themelus i LDK-së së bashku Agim Sheremeti. Dhe shumë here jam ofendu me mbiemer duke me hek i-në Ganiq me qellim nuk është keq me kon boshnjak por jam shqiptar dhe ndihna shqiptar, e nuk është keq me qenë boshnjak sepse të njejtin armik e kemi. Për me provu pozitën e opozitën jam duke i provu të dyja për pozitë shkon i vet qaty te patent shoferat çka janë duke bo, ndërsa për opozitë pom del kohë boll prej 5 ditëve të punës jam aktiv. Këto qeshtje të diskutimit nuk i kontribojnë kërkujt ju kisha lut shprehjet qytet-katund, katund –qytet duhet ti eliminojmë si qyteti si katundi janë pjesë të komunës së Pejës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: dua të ndalem te çështja e autizmit sespe është temë shumë e ndishme si kumë jemi të pregatitum me i ndihmu, edhe me nda edhe truall edhe jemi mundu me liru një objekt me jep për nevojat e autizmit. Problemi është se ne nuk mundem me pagu lokopedin që duhet me qenë aty, përsonein që duhet me punu me ata fëmijë i takon nivelit

qendror, komuna e Pejës ka qenë çdo here bashkëpunuse me secilen qeveri për çfardo objekti në interes publik na kemi nda truall! Ne si komunë për nevojat e autizmit mundem me nda ni truall dhe e gjejmë vendin e mirë që me pas adresen e saktë edhe me participu si komunë, por nuk mundem me punsu nuk na lejojnë me i punësu 2 a 3 përsona që duhet me qenë aty. Ne e ndajmë truallin e krejt ndërsa pjesa tjetër ju mbetet juve si nivel qendror, një pagë shtesë me siguru buxhetin për menagjimin e kësaj qendre dhe mundet me qenë qender racionale për pesë komunitat për përsonat me autizem.

Z.Drin Veselaj: sa i perket dr.Isalmit secili prej neve prej 35 asambleistëve kemi marr këshilla nga ai për shkak se është prej fillimit, edhe nga secili asambleist që qenë, mirëpo ne këtë rast dr.Islami, nuk e di për kend e pat fjalën, unë muj me fol për veti dhe për grupin tim nuk ka ndodhë asnjehere me ofendu ndonjë përson ktu dhe këtë e bazoj në shumë qështje. Gjatë diskutimit të asambleistit z.Bytyqi nuk është përmend asnjë fjalë ofenduse, përveq që ka tregu atë se çka ai mendon që është e vërtet. Edhe asaj se çka tha dr.Islami ishin ofendime të një pas njëshme duke thënë që ju nuk dini se për çka keni ardh ktu, ju nuk dini çka o planifikimi, çka o buxhetimi, shpenzimi! Dr.Islam, unë me juve kam punu prej 2013, për ato punë që i kemi bo të dy kemi qenë krenar me njëri-tjetrin ose e kemi mashtrur njëri-tjetrin prej 2013 ose sot po folim të pa vërtet, edhe unë kam qenë i kënaqur me ty dhe ju me mu të pakten ashtu jemi deklaruar. Edhe sa i perket asaj se dikush e din matematikën dhe dikush se din, ka disa qe e din matematikën dhe ka disa që e din hesapin dhe matematika me hesap kanë dallim sespe në hesap bëjnë sa ti ki qejf dhe matematika janë ato që janë. Edhe llogaritja që Labi e ka bo ke sipas asaj se ky qysh e ka llogarit ke vlerë e saktë, edhe pse nuk ish dasht me u ndal në një qështje të tillë në detaje. Sa i perket asaj që tha Naimi nuk duhet me kalu kështu, është mirë me koncentru gjatë fjalimeve të njerzve me sa unë mujta me kuptu që e para afer tha: është frigu vajza me shku në shkollë nga talltjet, e tregoj veprimi për çka është frigu me shku në shkollë. Prap po e cekim nuk ka ndodhë dhe as nuk ndodhë qe ne si grup me ofendu dikend, nuk ka ekzistuar dhe nuk ka me ekzistuar. Andaj nuk kem nevoj ktu për ligjerata dhe këshilla se si duhet me bo opozitë ose si duhet me fol na secili në profesionin e vet është i zoti aty ku punon. Unë, jam ekonomistë me profesion dhe mundohna ato që i di në ekonomi mundohna këtu me i përfaqësu, dhe kërkesat e qytetarëve por asnjehere me konstatu për një veprim që ka ndodhë, thjeshtë me i ngrit dyshimet e mija por gjithmonë duke i argumentu. U tha se asnjehere nuk është argumenti një shkelje e ligjit, e ki rastin e fundit kur kryetari i komunes e komuna janë denu 12 mijë e 500 euro, për shkelje të zones së mbrojtur, nese kjo nuk është faktë athere thuj ndale fjalimin shko në shpi. A nuk është shkelje e ligjit? Kryetari në emision e ka pranuar vet ka thënë e shkeli ligjin, e bëj dëmin, e paguaj!

Znj.Hidajete Krasniqi: sot me të vërtet nuk kam pas nder mend me bisedu , por më nxiti dr.Islami edhe përkunder respektit që e kam shumë të madhë. Që na potencoj që sa janë ndi dhe sa të ofendum janë .Por perderisa e konsideroj si një njeri të drejtë, nuk mu duke e drejtë! Se sa here na ka ofendu kryetari neve në çdo senacë, se fjalimet ju shkruan dikush dhe që nuk jemi njerëz në të njëjtin bagazh edhe me menaxhim edhe në udhëheqje por na nuk e kemi mar si ofendim,

por me pelqej ajo se çka tha se ju lumtë që keni arrit me bo nervoz një kryetar. Një kryetar nuk guxon me u bo nervoz dhe me dal nga vetvetja dhe me thonë se nuk mereni me ata që ju shkrujnë fjalimet. Sa i perket përgatitjes së raporteve dhe sa janë të përgatitum dhe na nuk po dim em bo matematiken, sot u vërejt sa lshimet edhe dr. Islami edhe vet ka dhënë vërejtje e mos të flasim në drejtëshkrime për procesverbale. Sot, u pa edhe mungesa e Jetonit sepse nuk ka ndodh me qenë kësi kaosi, dhe u vërejtë që edhe vet e pranun drejtorat dhe zyrëtarët që munden me ndodhë gabimet. Sa here jemi ofendu nga kryetari këtu që na shkrujnë fjalimet dhe ne nuk e kemi mar asnjehere si ofendim sepse ne secilijemi të vetdijshem për ata se çka shkrujmë dhe ata se çka folim.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë, po e shoh dhe po kuptoj shumë mirë sidomos të opozites dhe me i kthy seancat me shiku nese ka pas ofendime ka pas nga ana e tyre. Vetem kthejeni fajlimin e z. Bytyqi , ka pas shumë fjalë të rrënda në fjalim dhe ju e dini që kryetari nuk e kthen me buzëqeshje, por ju kthen në të njejten menyrë. Unë, i kam pa edhe postime unë rregulloren e kam thy vetem duke ju jep të drejtë me fol anëtarëve stë opozites 3-4 here dhe duke dal edhe jashtë teme, përndryshe unë nuk raport me ekzekutiv nuk jam dal asnjehere jashtë kornizes së rregullores.

Z. Feriz Gashi: kryesus, për ty nuk kemi asnjë vërjetje, je shumë korektë dhe nuk kemi çka me thënë, dikush mundet me ta pas lakmi ka pas qejf me kon në vend tëndin, por nuk është çka me bo tash! Kryesus, kryetari tha se nuk e kam asfaltu rrugen se nuk kam dashtë me thonë qe jam kryetar, edhe une ja kam mohu të drejten vajzes sime mos me apliku për bursë në drejtori të arsimit në Pejë vetem për faktin që nuk kam dasht me thonë që vajza e një asambleistit aplikoj për burës, edhe pse i ka plotësu të gjitha kriteret, është bursiste në universitet inxhinieri kompjuterike po pikërishtë për këtë arsye nuk kam dashtë! Megjithë respektin doktor, nuk tha Naimi që vajza nuk po guxon me shku në shkollë, por po heziton dmth ajo po shkon, por po heziton. Ne e kemi dëgju vet kryetarin kur thotë ja palosi dhe ja uli kryt, dhe une po them kështu mere fjalorin e gjuhës shiqpe dhe shiko njëren prej kuptimeve se çka do të thotë fjala palosi. Nqs doni unë ju shpjegoj por ka kuptim shumë të rrënd, dhe kur nuk e besoj që kryetari e ka mendu ata por e ka thënë në afekt.

Z. Islam Husaj: koleget e nderuar le ta shiqojnë inqizimin e seancës edhe nese e gjejnë diku që ka thënë atë fjalë, unë publikishtë do të kerkoj falje. E dyta, për mua është shumë shqetësuse pamvarsishtë prej asaj se po heziton apo spo shkon në shkollë është i njejt problem për mua kur një fëmijë hyn në qështjen e disktimeve tona. Dhe e fundit profesori ka të drejtë me i thonë dikujtë spo din, ndërsa kur dikush i thot këtij e mer si ofendim. Më së pari duhet me kqyr veten se çka po flet, e pastaj me i thonë dikujt!

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 13:45 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalën zyrtarë në Youtube.

Kliko: https://www.youtube.com/watch?v=KDZ3HzT4_Y0

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



KRYESUESI I KUVENDI,
z. Rexhep Kurtbogaj



